VENDIM
Nr. 775, datë 13.12.2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 422, DATË 6.5.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRBËRJEN, RREGULLAT E FUNKSIONIMIT DHE TRAJTIMIN FINANCIAR TË GRUPIT NEGOCIATOR DHE DETYRAT E KRYENEGOCIATORIT PËR ZHVILLIMIN E NEGOCIATAVE TË ADERIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", dhe të vendimit nr. 749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian", me propozimin e ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e Kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, të kreut I, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) fjalët "Znj. Adea Pirdeni" zëvendësohen me "Z. Tedi Dobi";

b) fjalët "Znj. Albana Tole" zëvendësohen me "Znj. Ana Kapaj";

c) fjalët "Znj. Almira Xhembulla" zëvendësohen me "Z. Sofjan Jaupaj";

ç) fjalët "Znj. Mimoza Kaçi, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, negociator në detyrë për kapitullin 9, deri në emërimin e drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv" zëvendësohen me "Znj. Mimoza Kaçi, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, negociator përgjegjës për kapitullin 9";

d) fjalët "Znj. Adela Xhemali, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë" zëvendësohen me "Znj. Adela Xhemali, zëvendësministër i Financave";

dh) fjalët "Znj. Enkela Dudushi, drejtor i Departamentit të Administratës Publike" zëvendësohen me "Znj. Adea Pirdeni, ministër i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin";

e) fjalët "Znj. Olta Manjani, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, negociator përgjegjës për kapitullin 2, si dhe bashkënegociator përgjegjës për kapitullin 19" zëvendësohen me "Znj. Olta Manjani, zëvendësministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, negociator përgjegjës për kapitujt 2 e 3, si dhe bashkënegociator përgjegjës për kapitullin 19";

ë) fjalët "Z. Endrit Yzeiraj, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, negociator përgjegjës për kapitujt 1, 3, 6, 7, 20 dhe 30, si dhe bashkënegociator përgjegjës për kapitujt 4, 28" zëvendësohen me "Z. Endrit Yzeiraj, zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, bashkënegociator përgjegjës për kapitullin 30";

f) fjalët "Znj. Jona Suli, drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës" zëvendësohen me "Z. Arbjan Mazniku, ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor";

g) fjalët "Znj. Vasilika Vjero, zëvendësministër i Financave dhe

Ekonomisë, negociator përgjegjës për kapitujt 16 dhe 29" zëvendësohen me "Zëvendësministri i Financave, përgjegjës për tatimet dhe doganat, negociator përgjegjës për kapitujt 16 dhe 29";

gj) pas paragrafit të fundit shtohen paragrafët, me këtë përmbajtje:

- Z. Enkelejd Musabelliu, zëvendësministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, negociator përgjegjës për kapitullin 1 dhe bashkënegociator përgjegjës për kapitujt 28 e 30;

- Z. Sokol Duma, zëvendësministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, negociator përgjegjës për kapitujt 7 e 20;

- Znj. Blerta Rama, zëvendësministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, negociator përgjegjës për kapitullin 6 dhe bashkënegociator përgjegjës për kapitullin 4.".

2. Në kreun V bëhen këto ndryshime:

a) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Shpenzimet e udhëtimit të anëtarëve të grupit negociator, të cilët nuk janë të punësuar nga institucionet publike dhe organet e administratës shtetërore, të përballohen nga buxheti i institucionit drejtues të kapitullit apo të kriterit të *acquis*-së së Bashkimit Evropian, në përputhje me legjislacionin, që rregullon mbulimin e shpenzimeve të udhëtimeve dhe për dietat për punonjësit e ministrive e të institucioneve buxhetore, kur dalin jashtë shtetit.".

b) Në pikën 7, emërtimi "Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme" zëvendësohet me "ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator".

II. Ngarkohen grupi negociator i Republikës së Shqipërisë dhe institucionet, sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku